



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr. 2633/B Prot.

Tiranë, më 21.06.2022

Të dhëna mbi vendimin e APP Nr. 59, datë 21.06.2022

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 78/1/a të Ligjit Nr. 162, datë 23.11.2020 "Për prokurimin publik", në ushtrim të kompetencave të saj, me Vendimin Nr. 07, datë 27.01.2022, ka vendosur të përjashtojë për 10 (dhjetë) muaj operatorin "Aliaj-79" Shpk, me NIPT L47521901E, nga e drejta për të fituar kontrata publike, pasi ka keqinformuar për qëllime kualifikimi.

1. Arsytet e heqjes së emrit të operatorit ekonomik nga lista e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike

Kundër vendimit Nr. 07, datë 27.01.2022 të APP, shoqëria "Aliaj-79" Shpk, me NIPT L47521901E, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar marrjen e masës së sigurimit të padisë, si dhe pezullimin e Vendimit të dhënë nga APP, Nr. 07, datë 27.01.2022.

Me vendimin Nr. 1545, datë 18.05.2022, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur pranimin e pjeshëm të kërkesë padisë konkretisht uljen e dënimit me 3 (tre) muaj, dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, si dhe rrëzimin për pjesën tjetër të kërkesë padisë.

Në nenin 510/a të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: "Janë tituj ekzekutivë: a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm".

Në këto kushte, APP, në mbështetje edhe të nenit 180, pika 1, gërma "b" të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", ka proceduar me heqjen e këtij operatori ekonomik në listën e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, që publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, si dhe në faqen zyrtare të APP, duke qenë se, afati 3 (tre) mujor ka përfunduar në datë 27.04.2022, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Gjykata Administrative e Apelit.